



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 39/
7 Prot.

Datë 15.01.2026

VENDIM

Nr. 11, datë 13.01.2026

**“PËR KONFIRMIMIN NË DETYRË TË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT
ANTON PALI, PROKUROR NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË
SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM Durrës”**

Bazuar në nenin 179/b, pikat 3 dhe 8, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në Ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenet 164, 166 dhe 189, pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe nenet 16 dhe 17, pika 2, të Vendimit nr. 169, datë 16.07.2025, “Për miratimin e Rregullores “Mbi zhvillimin e procedurave për rivlerësimin e subjekteve nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë”, me propozimin e Komisionit të Përkohshëm sipas Relacionit nr. 93, datë 06.01.2026, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Anton Pali, me detyrë Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
2. Ky vendim i arsyetuar i njoftohet subjektit të rivlerësimit Anton Pali, Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Vëzhguesit nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit Anton Pali dhe/ose Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.
U shpall në Tiranë, sot më 13.01.2026.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
Mirela Bogdani



ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Zeqir Hoda

ZV/KRYETAR
Erind Germenji

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Erion Fejzulla